

Sulm seksual dhe abuzim seksual

Informacion për të mbështetur azilkërkuesit në Mbretërinë e Bashkuar (MB)



A keni pësuar dëmtime për shkak të sulmit apo abuzimit seksual?



Sulmi ose abuzimi seksual mund t'i ndodhë kujtdo; ky mund të jetë një incident i vetëm ose të ndodhë në mënyrë të përsëritur. Kjo broshurë ofron informacion të rëndësishëm mbi të drejtat tuaja ligjore dhe mënyrën se si të merrni ndihmë nëse jeni sulmuar ose abuzuar seksualisht në të kaluarën ose aktualisht.



Ne e dimë se disa azilkërkues janë dhunuar dhe abuzuar seksualisht, si para mbërritjes së tyre, ashtu edhe gjatë qëndrimit në MB.



Azilkërkuesit mund ta kenë të vështirë të kenë mbështetjen dhe kujdesin e duhur në MB.

Ju keni të drejta



Gjithkush ka të drejtë të jetojë i qetë nga abuzimet.



Sulmi dhe abuzimi seksual janë vepra kriminale. Ju keni të drejtën ligjore për të raportuar çdo incident. Kjo nuk do të ndikojë në kërkesën tuaj për azil.



Biseda rreth sulmit dhe abuzimit seksual mund të jetë e pakëndshme, por duke folur rreth kësaj, ne mund të ofrojmë mbështetje dhe të ndihmojmë në parandalimin e këtyre krimeve.

Si mund ta di nëse kjo më ka ndodhur mua?

Çfarë është abuzimi seksual?



Çdo sjellje e padëshiruar ose e detyruar seksuale ndaj një të mituri ose fëmije pa pëlqimin e tyre përbën abuzim seksual. Fëmijët nën moshën 16 vjeç janë shumë të vegjël për të dhënë pëlqimin e tyre.



Kjo mund t'i ndodhë dikujt personalisht, në telefon, me tekst ose email, ose në internet.

Çfarë është sulmi seksual?



Çdo akt seksual pa pëlqimin ose kundër vullnetit të një personi përbën sulm seksual. Ai mund të përfshijë dhunë dhe përdhunim.



Sulmi seksual nuk është gjithmonë i dhunshëm, por mund të shkaktojë shqetësime të rënda, dëm emocional dhe lëndime të cilat nuk mund të shihen, por që janë po aq serioze.

Çfarë është përdhunimi?



Përdhunim do të thotë kur dikush e fut me qëllim penisin e tij në vaginë, anus ose në gojën e dikujt tjetër, pa pëlqimin e atij personi.

Çfarë është sjellja manipuluese?



Sjellje manipuluese është të miqësohesh dhe të mashtrosh dikë për të fituar besim e tij për qëllime të abuzimit, shfrytëzimit seksual ose trafikimit. Sjellja manipuluese mund t'i ndodhë kujtdo.

Çfarë është pëlqimi seksual?



Pëlqimi ndodh kur të gjithë personat e përfshirë në ndonjë aktivitet seksual pranojnë të përfshihen sipas dëshirës. Ata gjithashtu duhet të kenë lirinë dhe aftësinë për të bërë atë zgjedhje. Fëmijët (nën 16 vjeç) nuk mund të japin ligjërisht pëlqimin seksual.



Ne të gjithë kemi të drejtën ta refuzojmë marrëdhënien seksuale ose ndonjë formë të aktivitetit seksual. Kjo përfshin puthjen, prekjen seksuale, shikimin ose kryerjen e një akti seksual qoftë personalisht ose përmes një kamere, telefoni ose kompjuteri.



Të gjithë kemi të drejtën të ndryshojmë mendim në çdo kohë. Ne mund të pranojmë një akt të vetëm seksual, por gjithsesi kemi të drejtën të refuzojmë çdo lloj akti tjetër në çdo kohë.

Si mund ta di nëse dikush po cenon sigurinë time?



Kur një person tjetër shfaq sjellje të padëshiruara seksuale, ju keni të drejtën të ndiheni të sigurt dhe të thoni jo.

Këtu kemi disa shembuj:

- Komete të padëshiruara seksuale ose poshtëruese
- Pyetje të padëshiruara në lidhje me seksin ose orientimin seksual
- Ekspozim i panevojshëm i trupit të një personi
- Çdo akt seksual pa pëlqim
- Shkrepja e fotografive ose regjistrimi me video pa pëlqimin e personit
- Kur dikush ju detyron të shikoni pornografi ose imazhe të pahijshme
- Kur dikush sheh dikë që zhvishet pa pëlqimin e tij
- Prekje të padëshiruara
- Kur dikush ofron drogë ose shërbime për favore seksuale

Edhe kur janë të martuar, partnerët seksualë duhet t'i respektojnë këta kufij.



A ndiheni të sigurt apo keni nevojë për ndihmë?

- A keni shpesh frikë nga dikush ose një pjesëtar i familjes suaj?
- A jeni sulmuar fizikisht?
- A ju poshtëron apo kërcënon dikush se do t'ju lëndojë?
- A ju frikëson, kanos, kërcënon ose ofendon dikush për t'ju lënduar dhe kontrolluar?
- A duhet t'i kërkoni dikujt lejen për të shpenzuar paratë tuaja ose për t'u shoqëruar me miqtë dhe familjen?
- A ju kërcënon ndokush se do t'i lëndojë fëmijët tuaj ose do t'jua marrë ata?
- A ju prek dikush në mënyrë që ju nuk do të donit t'ju preknin?
- A ndiheni ndonjëherë nën presion për marrëdhënie seksuale kundër vullnetit tuaj?
- A ju ka shkatërruar dikush sendet tuaja për t'ju kontrolluar apo frikësuar?
- A ju ka marrë dikush pasaportën ose dokumente të tjera të rëndësishme?
- A ju ka shantazhuar dikush që të keni frikë të kërkoni ndihmë?
- A po martoheni kundër vullnetit tuaj?



Nëse i jeni përgjigjur me **PO** ndonjërës prej këtyre pyetjeve mund të jeni në një marrëdhënie ose situatë abuzive dhe kontrolluese.

Si të kërkoni ndihmë



Ju keni të drejtën të ndiheni dhe të jeni të sigurt. Nëse jeni sulmuar ose abuzuar seksualisht, **NUK** është faji juaj.



Sulmi dhe abuzimi seksual përbën krim, pa marrë parasysh se kush e kryen ose ku ndodh ai. Mos kini frikë të kërkoni ndihmë.



Si të rritur, nuk jeni të detyruar të raportoni sulmin ose abuzimin në polici nëse nuk dëshironi.



Për fëmijët duhet të ndiqen politikat dhe procedurat lokale të mbrojtjes. Për të dhënat e kontaktit të NSPCC, shikoni faqen 10.



Për të kuptuar të drejtat tuaja dhe mënyrën se si të kërkoni ndihmë, shihni faqen 10 e më tej për të dhënat e kontaktit të organizatave që mund t'ju ndihmojnë.

Përpara telefonatës suaj

- Përpiquni të gjeni një vend të sigurt. Nëse nuk jeni të sigurt, telefononi në nr. 999
- Sigurohuni që telefoni juaj të jetë i karikuar
- Nëse keni nevojë për përkthyes, kërkoni gjatë telefonatës

Nëse ndiheni menjëherë në rrezik

- Telefononi në nr. 999 dhe kërkoni policinë
- Informoni një anëtar të stafit të strehimit



Qendra e Ndhmës për Viktimat e Dhunës Seksuale (SARC)

SARC-të ofron hapësirë dhe kujdes të sigurt në çdo kohë për këdo që është përdhunuar, sulmuar ose abuzuar seksualisht.

Shërbimet përfshijnë:

- kriza dhe kujdes emocional
- ekzaminime mjekësore dhe mjeko-ligjore
- kontraceptivë urgjent
- teste për infeksione seksualisht të transmetueshme

Skanoi kodin QR për të gjetur një qendër SARC pranë jush.





Ju nuk keni nevojë të bëni kontrolle mjekësore. Por nëse e vendosni, atëherë është më mirë që kjo të ndodhë sa më shpejt të jetë e mundur.



Nëse po, atëherë një mjek specialist ose infermier mund t'ju ekzaminojë e të marrë dhe të ruajë çdo kampion mjeko-ligjor. Kjo NUK do të thotë që policia është e përfshirë.



Mundohuni të mos laheni ose ndërroni rrobat menjëherë pas një sulmi seksual. Kjo mund të shkatërrojë provat që mund të jenë të rëndësishme nëse dëshironi që policia të përfshihet në të ardhmen.



Të rriturit nuk janë të detyruar ta denoncojnë sulmin në polici. Zgjedhja është e juaja.

Të dhënat e kontaktit

Kur të telefononi ndonjë nga këto organizata, mbani mend se ju keni të drejtën të kërkonti një përkthyes në çdo kohë.



UDHËZUES

Shkarkoni aplikacionin NHS Safeguarding këtu:



Vizitoni: [england.nhs.uk/safeguarding/nhs-england-safeguarding-app/](https://www.england.nhs.uk/safeguarding/nhs-england-safeguarding-app/)



NSPCC Support for Children



Telefononi: **0808 800 5000**
(në dispozicion nga e hënë në të premte, 10:00-20:00)



Email: help@NSPCC.org.uk



England & Wales

Rape Crisis



Telefononi: **0808 500 2222**
(24 orë në ditë/çdo ditë të vitit)



Vizitoni: [247sexualabusesupport.org.uk](https://www.247sexualabusesupport.org.uk)



THE SURVIVORS TRUST

The Survivors' Trust



Telefononi: **0808 801 0818**



Vizitoni: [thesurvivorstrust.org/our-helpline](https://www.thesurvivorstrust.org/our-helpline)



For women and children.
Against domestic violence

National Domestic Violence Helpline



Telefononi: **0808 2000 247**



Galop (LGBTQ+)



Telefononi: 0800 999 5428

Respect

Men's advice line

Respect Men's Advice Line



Telefononi: 0808 801 0327




Ekipi juaj mbrojtës së fëmijëve ose të të rriturve pranë autoriteteve lokale

Vizitoni faqen e internetit të autoritetit tuaj lokal për të dhënat e kontaktit.



Vende të tjera ku mund të kërkonti ndihmë

- Ekipi i mbrojtjes së kujdesit social për fëmijët ose të rriturit pranë autoriteteve lokale
- Një mjek ose infermiere në klinikën tuaj të mjekut të familjes
- Departamenti i Aksidenteve dhe Urgjencës në spital (A&E)
- Një mjek gjeniturar (GUM) ose klinikë e shëndetit seksual
- Një klinikë kontraceptive
- Një shërbim për të rinjtë
- Telefononi **111** ose vizitoni: **111.nhs.uk**
- Nëse ndiheni menjëherë në rrezik, telefononi **999** dhe kërkonti policinë
- Nëse nuk jeni menjëherë në rrezik, flisni me policinë në nr. **101**



Këshilla për t'u ndjerë më të sigurt


Sulmi ose abuzimi seksual nuk është **KURRË** për fajin tuaj. Ka disa gjëra që mund të bëni që mund t'ju ndihmojnë të ndiheni më të sigurt.

Merrni masa paraprake kur dilni jashtë - veçanërisht nëse dilni vetëm



Të dini se si do të ktheheni në vendin ku jetoni. Të planifikoni paraprakisht nëse do të shkoni diku që nuk e dini. T'i tregoni një miku ose një pjesëtar të familjes se ku po shkoni dhe se kur duhet të ktheheni.

Telefonin ta keni të karikuar



Sigurohuni që celulari juaj të jetë i karikuar dhe në gjendje për të bërë telefonata, në rast urgjence ose në rast se humbni njerëzit me të cilët jeni.

Mbajini në vend të sigurt sendet personale



Mos i postoni të dhënat personale në internet. Mos e jepni adresën ose numrin tuaj të telefonit. Mos ftoni njerëz në vendin ku po qëndroni të cilët nuk i njihni mirë.

Organizata të tjera që mund të ofrojnë mbështetje



The Refugee Council



Vizitoni: refugeecouncil.org.uk/get-support/services



Micro Rainbow

Mbështetje për lesbiket, homoseksualët, biseksualët, transgjinerët



Vizitoni: microrainbow.org/contact-us



Migrant Help

Për të gjitha shqetësimet në lidhje me strehimin:



Telefoni: 0808 8010 503



Vizitoni: migranthelpuk.org



Freedom from Torture



Vizitoni: freedomfromtorture.org





Këshilla dhe udhëzime për çështje të azilit

Për të lexuar këshillat dhe udhëzimet për çështje të azilit, skanoni kodin QR.



Këshilla të përkthyer:

Të disponueshme në gjuhët e mëposhtme:

- Arabisht
- Shqip
- Amharike
- Panxhabi (indiane)
- Farsi
- Sorani kurde
- Mandarin
- Pashto
- Spanjisht
- Tigrinja
- Urdu



Përkthime

Kjo fletëpalosje është gjithashtu e disponueshme në gjuhët e mëposhtme:

- Shqip
- Arabisht
- Farsi
- Sorani kurde
- Pashto

Për më tepër vizitoni faqen:
migranthelpuk.org

